



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTRI

MINISTRIA E SHENDETËSISË  
MINISTRI

Nr. 2/1 Prot. Datë 12/8 2013

Nr. 216/12 Prot. Datë 12/8 /2013

UDHËZIM

Nr. 446 Datë 12/8 /2013

**Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 15.01.2013 "Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave "**

Në zbatim të ligjit Nr. 10381, datë 24.02.2011, "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontratues dhe shoqërive "Sicpa Security Solutions S.A " e "Sicpa Security Solutions Albania shpk", për projektimin, financimin, dizejimin, prodhimin, dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave" si dhe pikes 9 te nenit 20 te ligjit nr. 9323 datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë:

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.2, datë 15.01.2013 "Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave " bëhen keto ndryshime:

1. Pika 16.1, ndryshohet si më poshtë:

16.1 Për të gjitha subjektet farmaceutike zbatimi i udhezimit do të fillojë 10 muaj nga data e hyerjes në fuqi të këtij udhëzimi. 10 muaj nga data e hyrjes në fuqi e ketij udhëzimi, nuk do të lejohen të importohen barna si

dhe nuk do të lejohen të hidhen në treg barna të prodhuara në vend pa pullën e vetme të kontrollit të barnave të prodhuar nga koncesionari.

2. Pika 16.2, ndryshohet si më poshtë:

16.2. Pas periudhës prej 10 muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, inspektimet nga autoriteti në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, do të kryhen në të gjithë territorin e vendit. Për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi do të zbatohen sanksionet e percaktuara në ligjin nr.9323 datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në RSH" i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE**  
**RIDVAN BODE**

  


**MINISTËR I SHËNDETËSISË**  
**HALIM KOSOVA**

  
